



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR PËR
ZBATIMIN E RAKOMANDIMEVE NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR ZBATIMIN E RAKOMANDIMEVE
NË
MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë 2022

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 226/3 prot., datë 21.02.2022. Auditimi është kryer nga:

1. F.I., (përgjegjëse grupi);
2. E.S., anëtar;
3. K. Sh., anëtar.

Periudha e auditimit 01.01.2021-31.12.2021

Afati i auditimit 16.02.2022-28.02.2022

Auditimi i është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 226/3 prot., datë 21.02.2022 me objekt: ÷Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Projektin ÷Modernizimi i Asistencës Sociale÷ në zbatim të programit nr. 226/3 prot., datë 21.02.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me objekt mbi ÷Auditim ÷Financiar, të cilat janë përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 873/9 prot, datë 14.04.2021, protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 1859 prot., datë 16.04.2021, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të nenit 15, shkronja ÷j, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1859/1 prot., datë 18.05.2021 ÷Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është hartuar programi i punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit i firmosur nga O.M. me detyrë Ministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i padatur në të cilën për çdo masë organizative janë ngarkuar drejtoritë përkatëse.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6-mujsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

HYRJE

Ky auditim ka të bëjë me zbatimin e Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr.1, datë 04.11.2016 ÷Për procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky auditim ka marrë në analizë dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje, sipas rastit dhe problematikës së evidentuar gjatë auditimit.

Rezultatet e auditimit

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimi i rekomandimeve është si më poshtë:

Në raportin përfundimtar mbi auditimin financiar të dërguar me shkresën nr. 873/9 prot, datë 14.04.2021, janë rekomanduar 12 masa organizative.

Nga 12 masa organizative, 10 janë në proces zbatimi, ndërsa dy rekomandime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror janë konsideruar të ezauruara, pasi në zbatim të VKM nr 597, datë 04.09.2019 për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike është miratuar shtojca nr. 4 e Listës së familjeve/ individëve në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike për periudhën.

Theksojmë: Ky projekt ka si afat të përcaktuar për përfundimin e tij datën 30.06.2021. Për arsye të situatës së krijuar nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe Pandemisë së Covid në vitin 2020, data e mbylljes së projektit u shty deri në datë 31.12.2022 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 14.04.2021.

Deri në datë 24.02.2022, datë e verifikimit të realizimit të masave të rekomanduara, zbatimimi është realizuar si më poshtë:

MASA ORGANIZAVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportimeve 3 mujore për marrëveshjen e ratifikuar sipas ligjit nr. 84/2012, e ndryshuar dhe raportimeve 6 mujore për marrëveshjen e ratifikuar sipas ligjit nr. 54/2018, rezultoi se në marrëveshjen e parë indikatorët nr. 4, 11, 12, 15 dhe 16 nuk janë arritur sipas afatit të parashikuar në dokumentin POM (*Manuali Operacional i Projektit*), pavarësisht faktit se janë arritur brenda afatit përfundimtar të marrëveshjes. Gjithashtu, e njëjta situatë rezultoi edhe për indikatorin nr. 19 të marrëveshjes së dytë. Sa më sipër është në kundërshtim me Manualin Operacional të Projektit të vitit 2018, Aneksi J dhe Manualin Operacional të Projektit të vitit 2019, Aneksi C. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/PMU të marrin masat e nevojshme për realizimin në kohë të indikatorëve të planifikuar, për të mundësuar kryerjen e disbursimeve me qëllim eliminimin e efekteve të mundshme financiare negativ që sjell mosrealizimi (pagesat, transhet) dhe arritjen e qëllimit të projektit, në mbështetje të reformave për Ndihmën Ekonomike.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Indikatorët që lidhen me disbursimin (ILD), skeduli i katërt.

ILD-17: ò a) Të paktën 66 për qind e kërkesave të reja dhe kërkesave për ricertifikim të ardhura në të gjitha njësitë administrative të 3 Qarqeve pilot janë përpunuar përmes PAK-së së automatizuar; dhe b) SIM i PAK-së është zgjeruar për të përfshirë funksione të fazës së dytë, përfshirë integrimin e të dhënave nga vlerësimi i rishikuar i të drejtës për të përfituar në bazë të Modelit Socialë.

Indikatorin ILD-17 është në proces përgatitja e dokumentacionit që do të paraqitet në Bankën Botërore për realizimin e këtij indikator.

ILD-18: ò Zyrrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në secilin prej tri qarqeve pilot rehabilitohen sipas standardeve të cilësisë të parashikuara në aktet rregullatore zyrtare për akomodimin e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Me shkresën nr. 962 prot., datë 22.02.2022 të Zëvendës Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale njoftohet mbi realizimin e protokollit të indikatorit të disbursimit ILD-18, indikator i realizuar dhe i raportuar në Bankë, në proces miratimi nga Banka Botërore dhe më pas disbursimi i shumës përkatëse.

ILD-20: Është hetohet nga inspektorët socialë në përputhje me protokollin e verifikimit të paktën 55 për qind e rasteve të dyshuara për mashtrim dhe gabim në PAK në Tiranë.

Indikatori ILD-20 është në proces.

ILD-19: Është përgatitur, konsultuar, miratuar dhe shpërndarë në përputhje me protokollin e verifikimit një strategji e daljes dhe një plan veprimi për përfituesit e PNE-së.

Në bazë të dokumentit datë 22.04.2020, i ardhur nga World Bank Payment Advice me anë të sistemit Client Connection të Bankës Botërore, i cili i është dërguar Ministrisë së Financave, me transaksionin nr. 0004, projekti P122233, ku përfitues është llogaria e Shtetit Shqiptar, për të konfirmuar transferimin në vlerën 2,202,500 dollar në llogari të Bank Of Albania. Konkretisht me e-mailin e datës 30.04.2020 dërguar nga Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE, konfirmohet kalimi në llogarinë e qeverisë në datë 22.04.2020 të shumës 2,202,500 dollarë.

Indikatori është realizuar

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi).

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e financimit, PMU ka raportuar mbi fondet e alokuara në fillim të vitit për programin e NE nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Konkretisht:

- Vlerat e raportuara nga DPSHSSH për vitin 2018 si buxhet i alokuar për programin e NE (Ndihma Ekonomike + Personat me Aftësi të Kufizuara) nuk kanë rialokime fondesh;

- Për vitin 2019 janë evidentuar se vetëm për 21 Bashki, të përzgjedhura këto në bazë të vlerave më larta, duke krahasuar vlerën e alokimit të raportuar në Bankën Botërore me vlerën e alokuar deri në fund të vitit sipas DPSHSSH, rezulton se në 11 raste ka diferenca midis vlerave të raportuara si të alokuar dhe alokimit përfundimtar në shumën **127,000,000 lekë**. Rialokimet për vlerat e mësipërme janë kryer me shkresat nr. 5162, datë 14.11.2019 dhe shkresa nr. 6006, datë 30.12.2019 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Duke qenë se raportimi nga PMU ndaj Bankës Botërore bëhet 6-mujor progresiv e vjetor për vitin financiar dhe është pas faktit, si i tillë ky raportim duhet të kishte përfshirë këto ndryshime shumash të alokuara. Sa më sipër, është në kundërshtim me Seksionin II, Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit, germa A Raportet e Projektit, pika 2 dhe germa B Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimet, pika 2 të Ligjit nr. 84/2012 *'Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale'*, seksionin II të ligjit nr. 53/2018 *'Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale'*, si dhe Manualin Operacional i Projektit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror dhe PMU të marrin masa që në raportet e dorëzuara pranë donatorit (Banka Botërore) të pasqyrojnë vlerat e plota të alokuara për programin e NE ku të përfshihen fondet e çelura dhe rialokimet e ndodhura gjatë vitit, si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e financimit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me shkresën me nr. 30 prot., datë 09.02.2022 është dërguar në Bankën Botërore, Progres Raporti për 6-mujorin e dytë të vitit 2022, ku në aneksin D, të këtij raporti janë dërguar të dhënat për çeljen e Buxhetit për programin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar për periudhën janar-dhjetor 2021, sipas të dhënave të dërguara me e-mailin e datës 04.02.2022 nga Sektori i Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MSHMS, ku përfshihen të gjitha çeljet dhe rialokimet e kryera gjatë vitit 2021.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi).

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se evidencat statistikore të hartuara nga Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në NJVV, të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe mandej në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pasqyrojnë më shumë/më pak shpenzime në krahasim me të dhënat e marra nga rakordimet e bëra me sistemin e Thesarit. Kjo diferencë rezulton akoma më e lartë për vitin 2018, vit gjatë të cilit Programet NE dhe PAK kanë qenë pa kode të veçanta në sistemin e Thesarit por me një kod të përbashkët. Konkretisht:

- Për vitin 2018 rezulton një diferencë prej **2,814,346,626 lekë** (*1,609,050,296 lekë raportuar më shumë + 1,205,296,330 lekë raportuar më pak*), këto duke krahasuar shumat sipas sistemit të thesarit dhe vlerës së raportuar nga evidencat statistikore të konsoliduara në nivel Republike nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH. Thënë ndryshe, shpenzimet e kryera nuk janë shoqëruar me evidencën përkatëse (evidencat statistikore) (*Aneksi 4.1*).

- Për vitin 2019 rezulton një diferencë prej **121,806,743 lekë** (*101,859,772 lekë raportuar më shumë + 19,946,971 lekë raportuar më pak*), këto duke krahasuar shumat sipas sistemit të thesarit dhe vlerës së raportuar nga evidencat statistikore të konsoliduara në nivel kombëtar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH. Thënë ndryshe, shpenzimet e kryera nuk janë shoqëruar me evidencën përkatëse (evidencat statistikore) (*Aneksi 4.1*). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 2 të Udhëzimit nr. 10 datë 03.07.2014 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 1945, datë 4.10.2010, për zbatimin e Vendimit Nr. 617, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e Treguesve të Vlerësimit dhe të Monitorimit të Programeve të Ndihmës Ekonomike, të pagesës për personat me Aftësi të Kufizuara dhe të Shërbimeve Shoqërore”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 24-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Zyrat e Shërbimit Social në NJVV, nisur jo vetëm nga rëndësia që ka Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale, por edhe vet Ndihma Ekonomike si politikë sociale për shtresat në nevojë, të marrin masa që të hartohen dhe plotësohen statistika mbi vlera reale të shpenzuara.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 617 , datë 20.10.2021, ÷Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre, është përcaktuar formati i mbledhjes së të dhënave dhe i indikatorëve të monitorueshëm dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre për programin e ndihmës ekonomike. Në zbatim të këtij vendimi, me urdhër nr. 107, datë 11.02.2022 të G.P. me detyrë Sekretare e Përgjithshëm e Ministrisë është

ngritur grupi teknik i punës, për përcaktimin e treguesve statistikorë dhe për planifikimin e fondeve të programeve të mbrojtjes sociale. Urdhër i cili është dërguar me e-mail zyrtar me datë 14.02.2022 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi).

3.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Zyrat e Shërbimit Social në NJVV, nisur jo vetëm nga rëndësia që ka Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale, por edhe vet Ndihma Ekonomike si politikë sociale për shtresat në nevojë, të marrin masa për të analizuar problematikat në sistemin e saj të raportimit dhe të hartohet një skemë e qartë në nivel institucional mbi përgjegjësitë e hartimit dhe rakordimit të shifrave midis sektorëve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 617 , datë 20.10.2021, ÷Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre, është përcaktuar formati i mbledhjes së të dhënave dhe i indikatorëve të monitorueshëm dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre për programin e ndihmës ekonomike. Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhër nr. 107, datë 11.02.2022 të G.P. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, është ngritur grupi teknik i punës për përcaktimin e treguesve statistikorë dhe për planifikimin e fondeve të programeve të mbrojtjes sociale.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi).

3.3 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Zyrat e Shërbimit Social në NJVV, nisur jo vetëm nga rëndësia që ka Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale, por edhe vet Ndihma Ekonomike si politikë sociale për shtresat në nevojë, të marrin masa për të vlerësuar mundësinë e hartimit të një formati të ri raportimi në të cilën të paraqiten shumat e shpenzuara faktike si dhe detyrimet e prapambetura për çdo 2-mujor.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 617 , datë 20.10.2021, ÷Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre, është përcaktuar formati i mbledhjes së të dhënave dhe i indikatorëve të monitorueshëm dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre për programin e ndihmës ekonomike. Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhër nr. 107, datë 11.02.2022 të G.P. me detyrë Sekretare e Përgjithshëm e Ministrisë, është ngritur grupi teknik i punës për përcaktimin e treguesve statistikorë dhe për planifikimin e fondeve të programeve të mbrojtjes sociale. Urdhër i cili është dërguar me e-mail zyrtar me datë 14.02.2022 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi).

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht nga krahasimi i shumave të raportuara si të shpenzuara nga Drejtoria e Financës dhe Statistikave në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH (akt ó rakordimet akordimet me MFE) me evidencat

statistikore të Drejtorive Rajonale të SHSSH, rezultoi se edhe me këto evidenca, ashtu sikurse me ato të konsoliduara në nivel kombëtar, për vitin 2018, kanë një diferencë prej **2,863,409,097 lekë** (1,609,706,542 lekë raportuar më shumë + 1,253,702,555 lekë raportuar më pak). Pra evidencat statistikore të Drejtorive Rajonale të SHSSH pasqyrojnë më pak shpenzime se sa shumat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH në akt-rakordimet e saj me sistemin e Thesarit. Nga auditimi rezultoi me diferenca për të njëjtën arsye edhe viti 2019 me një shumë prej **114,790,201 lekë** (95,293,294 lekë raportuar më shumë + 19,496,907 lekë raportuar më pak). Pra evidencat statistikore të Drejtorive Rajonale të SHSSH pasqyrojnë më pak shpenzime se sa shumat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH në akt-rakordimet e saj me sistemin e Thesarit (Aneksin nr. 4.2 *Krahasimi i shumave të rakorduara nga Drejtoria e Financës dhe Statistikave (DPSHSSH) me evidencat statistikore të marra nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH*). Për të dy vitet diferenca rezultoi nga fakti se këto evidenca statistikore të mbajtura pasqyrojnë vetëm shpenzimet faktike të kryera për dy mujorin e kaluar dhe detyrimet e prapambetura nuk përfshihen në evidenca statistikore duke arritur në një situatë ku shumat e shpenzuara me ato të shoqëruara me evidencë statistikore të kenë edhe diferencat e mësipërme. Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1945 datë 04.10.2010 òPër zbatimin e VKM Nr. 617, datë 07.9.2006, òPër Përcaktimin e Treguesve të Vlerësimit dhe të Monitorimit të Programeve të Ndhmës Ekonomike, të pagesës për personat me Aftësi të Kufizuara dhe të Shërbimeve Shoqërore, i ndryshuar, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 24-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Zyrat e Shërbimit Social në NJVV, nisur jo vetëm nga rëndësia që ka Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale, por edhe vet Ndhma Ekonomike si politikë sociale për shtresat në nevojë, të merren masa për përmirësimin e mënyrës së plotësimit të evidencave statistikore nga ana e NJVV si një element shumë i rëndësishëm në çeljen e fondeve për periudhat pasardhëse për programin e NE ku të përcaktohen qartë detyrimet e prapambetura në pagesat e përfituesve dhe pagesat faktike të kryera të periudhës së raportimit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 617 , datë 20.10.2021, òPër treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre, është përcaktuar formati i mbledhjes së të dhënave dhe i indikatorëve të monitorueshëm dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre për programin e ndihmës ekonomike. Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhër nr. 107, datë 11.02.2022 të G.P. me detyrë Sekretare e Përgjithshëm e Ministrisë, është ngritur grupi teknik i punës për përcaktimin e treguesve statistikorë dhe për planifikimin e fondeve të programeve të mbrojtjes sociale. Urdhër i cili është dërguar me email zyrtar me datë 14.02.2022 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi).

4.2 Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Zyrat e Shërbimit Social në NJVV, duke patur parasysh faktin se pasqyrimi në evidenca statistikore manualisht nga ana e punonjësve mbart një risk të lartë gabimi, të

vlerësohet mundësia e gjenerimit të tyre nga ana e sistemit elektronik të Projektit Modernizmi i Asistencës Sociale.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 617 , datë 20.10.2021, òPër treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre është përcaktuar formati i mbledhjes së të dhënave dhe i indikatorëve të monitorueshëm dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre për programin e ndihmës ekonomike. Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhër nr. 107, datë 11.02.2022 të G.P. me detyrë Sekretare e Përgjithshëm e Ministrisë, është ngritur grupi teknik i punës për përcaktimin e treguesve statistikorë dhe për planifikimin e fondeve të programeve të mbrojtjes sociale. Urdhër i cili është dërguar me email zyrtar me datë 14.02.2022 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi). Verifikimi i detajuar i zbatimit këtij rekomandimi, do të auditohet në auditimin e ardhshme të këtij projekti.

5. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se evidencat statistikore 2-mujore të NJVV konsolidohen në nivel Drejtorie Rajonale dhe raportohen më pas në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Sektori i Statistikave në Drejtorinë e Përgjithshme konsolidon statistikën në nivel kombëtar dhe i paraqet ato pranë sektorit të Financës të cilat më tej përdoren si burim informacioni për çeljen e fondeve në 2 mujorin pasardhës.

Grupi i auditimit krahasoi statistikën e raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH me ato të hartuara e dërguara nga Drejtoritë Rajonale, nga ku rezultuan diferenca në vlerë të përshkruara këto si më poshtë:

a. Për vitin 2018, ka një mospërputhje midis vlerave ku në **16 raste** Drejtoritë Rajonale kanë raportuar në total **10,914,876 lekë** më shumë se vlera e raportuar nga Sektori i Statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe në **20 raste** Drejtoritë Rajonale kanë raportuar më pak në vlerën **5,138,443 lekë** se Sektori i Statistikave në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH.

b. Për vitin 2019, ka një mospërputhje midis vlerave ku në **20 raste** Drejtoritë Rajonale kanë raportuar në total **7,684,206 lekë** më shumë se vlera e raportuar nga Sektori i Statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe në **9 raste** Drejtoritë Rajonale kanë raportuar më pak në vlerën **1,330,556 lekë** se Sektori i Statistikave në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH.

(Aneksi nr. 4.3 *Krahasimi i vlerave të evidencave statistikore mes raportimeve 2-mujore të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe atyre të Drejtorive Rajonale të SHSSH*. Veprimet e mësipërme në kundërshtim me pikën 2 të Udhëzimit nr. 10 datë 03.07.2014 òPër disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 1945, datë 4.10.2010, për zbatimin e Vendimit Nr. 617, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, òPër Përcaktimin e Treguesve të Vlerësimit dhe të Monitorimit të Programeve të Ndihmës Ekonomike, të pagesës për personat me Aftësi të Kufizuara dhe të Shërbimeve Shoqërore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 24-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të marrin masa që çdo paqartësi apo ndryshim në nivel konsolidimi të statistikave të kërkohet shpjegim nga niveli bazë (Bashkia), të argumentohet ndryshimi dhe dokumentohet në mënyrë që i gjithë sistemi i programit të NE të ketë pasqyruar realizimin të

konsoliduar në nivel kombëtar ku të pasqyrojë situatën reale të fondeve të shpenzuara për këtë program në nivel kombëtar.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 617 , datë 20.10.2021, òPër treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyreò, është përcaktuar formati i mbledhjes së të dhënave dhe i indikatorëve të monitorueshëm dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre për programin e ndihmës ekonomike. Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhër nr. 107, datë 11.02.2022 të G.P. me detyrë Sekretare e Përgjithshëm e Ministrisë, është ngritur grupi teknik i punës për përcaktimin e treguesve statistikorë dhe për planifikimin e fondeve të programeve të mbrojtjes sociale. Urdhër i cili është dërguar me email zyrtar me datë 14.02.2022 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi). Verifikimi i detajuar i zbatimit këtij rekomandimi do të auditohet në auditimin e ardhshme të këtij projekti.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në 6 NJVV të 110 dosjeve për vitet 2018 ó 2019 rezultuan problematika dhe mangësi si më poshtë:

Bashkia Elbasan:

- Në 41 raste në verifikimin e bërë nga ana e Administratorëve Shoqërorë, nuk është bërë një përshkrim sipas pikës 29 të formularit ‘*Përshkrim i shkurtër i nivelit të jetesës së aplikantit*’ ;
- Në 1 rast nuk është kryer verifikimi në terren i situatës social ekonomike nga ana e Administratorit Shoqëror;
- Në 1 rast rezultoi se mungon deklarata 3 ó mujore;

Bashkia Përrenjas:

- Në 3 praktika rezultoi se 3 deklarata 3-mujore të një përfituesi janë pa datë, fakt i cili nuk konfirmon nënshkrimin e deklaratës brenda datës 1 ó 15 të muajit deklarues;
- Në 7 raste rezultoi se nuk është plotësuar tabela sipas shtojcës nr. 3 “*Përbërja dhe Gjendja e Familjeve*”;
- Në 16 raste rezultoi se nuk është bërë një përshkrim sipas pikave 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 tek Seksioni A “*Informacion specifik mbi aplikantin*” si dhe
- Në 17 raste rezultoi nuk janë pasqyruar të dhëna në lidhje me seksionin C “*Informacion Specifik mbi Aplikimin/Demografia e Familjes*”;
- Në 5 raste rezultoi nuk janë pasqyruar të dhëna në lidhje me ndryshimet/ose jo të Gjendjes Ekonomike dhe Sociale të familjes;
- Në 2 raste u konstatua se mungon Formulari i vlerësimit të situatës social ó ekonomike në terren për 6 ó mujorin e dytë;

Bashkia Librazhd:

- Në 3 raste nuk është kryer verifikimi në terren i situatës social ekonomike nga ana e Administratorit Shoqëror;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 2, Kreu II të Udhëzimit nr. 3, datë 17.02.2017 “*Mbi zbatimin e vendimit të KM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kritereve, procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike” dhe VKM Nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 24-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga Administratorët Shoqërorë, të merren masa për plotësimin e të dhënave të kërkuara në formularin e vlerësimit të situatës sociale ekonomike me qëllim evidentimin e situatës reale të përfituesve të NE.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Me shkresën nr. 611/4 prot., datë 11.12.2019, Drejtoria Rajonale e SHSSH ka ushtruar kontroll në Bashkinë Elbasan për periudhën 01.09.2018 deri në 30.09.2019, ku ka dërguar raportin përfundimtar. Me shkresën nr. 34/6 prot., datë 03.03.2020 është dërguar Raporti i kontrollit të kryer në Bashkinë Librazhd për periudhën 01.03.2018 deri në 31.12.2019. Me shkresën nr. 406/5 prot., datë 30.03.2021, është dërguar raporti i kontrollit të ushtruar në Bashkinë Përrenjas për periudhën kohore 01.01.2019 deri në 31.01.2021.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi). Verifikimi i detajuar i zbatimit këtij rekomandimi do të auditohet në auditimin e ardhshme të këtij projekti.

6.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Zyrat e Shërbimit Social në NJVV, të marrin masa për hedhjen nga ana e Administratorëve Shoqërorë në sistem të formularëve të skanuar me qëllim shmangien e riskut për shkak të gabimeve njerëzore gjatë hedhjes së tyre në mënyrë manuale sipas qelizave në sistem.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është konsideruar i ezauruar nga Ministria dhe SHSSH, pasi në zbatim të VKM nr 597, datë 04.09.2019 òPër përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike është miratuar shtojca nr. 4 òLista e familjeve/ individëve në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike për periudhën.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta të fondeve të alokuara/shpenzuara, u kryqëzuan të dhënat për një 2 mujor për vitin 2018 dhe të gjithë vitin 2019 (gjashtë 2-mujore) mes atyre të deklaruara nga Drejtoria e Financës dhe Statistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH dhe Drejtorisë së Financës së secilës prej këtyre 6 NJVV. Konkretisht, për vitin 2018 një diferencë prej **33,036,168 lekë** (33,018,168 lekë raportuar më shumë + 18,000 lekë raportuar më pak) dhe për vitin 2019 rezulton një diferencë prej **16,862,313 lekë** (16,729,781 lekë raportuar më shumë + 132,532 lekë raportuar më pak). Këto diferenca rezultuan mes shumës së rakorduar mes Sektorit të Financës në DP të SHSSH me Ministrinë e Financave dhe asaj të rakorduar mes Sektorit të Financës në Bashkitë e përzgjedhura me sistemin e thesarit. Duhet sqaruar fakti se për rastin e asaj të vitit 2018 nuk mund të arrihet në konkluzion të saktë mes shumave të raportuara pasi për këtë vit shpenzimet sipas DP SHSSH janë bërë jo sipas faktit por me përqindje (shiko gjetjen nr. 2). (Shiko aneksin 4.5)..Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 188 dhe 189 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të qeverisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 24-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, Drejtoritë Rajonale të SHSSH dhe Drejtorive të SHSSH në NJVV të merren masa në të ardhmen për rakordimin e shumave mes Drejtorive/Sektorëve të Financës mes asaj të DP të SHSSH dhe atyre të NJVV.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi (realizimi). Verifikimi i detajuar i zbatimit këtij rekomandimi do të auditohet në auditimin e ardhshme të këtij projekti.

8. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për Bashkinë Elbasan, rezultoi se për vitin 2018 dhe deri në nëntor të vitit 2019, Projekt Vendimet e hartuara nga struktura përgjegjëse për Shërbimet Sociale në Bashki dhe Vendimet e marra nga ana e Këshillit Bashkiak nuk kanë të bashkëngjitur listën e familjeve por vetëm kategoritë përfituese dhe vlerat përkatëse, në kundërshtim me pikën 6, Kreu II të VKM Nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, si dhe pikën 7, Kreu II, VKM Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 24-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Drejtoritë e Shërbimit Sociale në NJVV, të marrin masa për marrjen e miratimeve të nevojshme në shkallët hierarkike sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator të përcaktuar për përfitimin e Ndihmës Ekonomike me qëllim rritjen e transparencës së procesit të dhënies së Ndihmës Ekonomike dhe shmangien e veprimeve formale.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është konsideruar i ezauruar nga SHSSH, pasi në zbatim të VKM nr 597, datë 04.09.2019 për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike është miratuar shtojca nr. 4 të Listës së familjeve/ individëve në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike për periudhën.

GRUPI I AUDITIMIT

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

F. I.

R. XH.

E. S.

K. Sh.